



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.182/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Adnan Konusheci dhe Faton Ademi Gillogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Bajram Rexhahmetaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, paraqitur kundër koalicionit LDK-AKR dega në Gjakovë, për shkak të vendosjes së posterev në shtylla elektrike për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 10.06.2017, mori këtë:

VE N D I M

Refuzohet si të pabazuara ankesa Anr.182/2017, 183/2017, 184/2017, 186/2017, 187/2017 e dates 10.06.2017, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV).

A r s y e t i m

Me datën 10.06.2017, PZAP-i ka pranuar ankesat nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, me të cilën pretendon se me datën 06.06.2017, në rrugën “UCK” në Gjakovë, aktivisti i tyre ka vërejtur se nëpër shtylla elektrike ishin vendosur posteritë e kandidatëve për deputete nga Koalicionit LDK-AKR.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se nga ana e Koalicionit LDK-AKR, është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 4.1 pika b e Rregullës Zgjedhore të KQZ-së 11/2013, sepse vendosja e materialit zgjedhor në apo mbi rrugë përbënë veprim të ndaluar për subjektet politike, kandidatët dhe mbështetësit e tyre.

Në përgjigjet e ankesave të datës 10.06.2017, Koalicioni LDK-AKR thekson se pas pranimit të Urdhërit për Përmirësim kanë kërkuar nga kandidati dhe dega në Gjakovë për të ndërmarr veprime përmirësuar, mirëpo kandidati kanë konfirmuar se për të vendosur bilbordët e koalicionit dhe banerve ne vendet dhe hapësirat publike kanë marre leja nga komuna. Lidhur me përgjigjen në ankesat pala i ka bashkangjitur fotografi dhe vendimin e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtjen e te Mjedisit në Gjakovës.

Paneli i PZAP-it, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar ankesat e lartcekura dhe i trajton si një ankesë evidentuar me Anr.182/2017 për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve, dhe për 5(pesë) ankesat i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se

Ankesa është e pabazuar

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë, Paneli konstaton se nga ana e koalicionit LDK-AKR, nuk është bërë shkelja e nenit 33 pika (b) të LZP-së, pasi që baneret e koalicionit LDK-AKR, janë të vendosur pikërisht në vendin e dedikuar për reklamim - vendosje së banerëve.

Paneli gjatë shqyrtimit të ankesave konstatoi se të njëjtat janë të pabazuara ngase posterët e vendosur nga koalicioni LDK-AKR, janë të vendosur në vende të lejuara nga Komuna e Gjakovës për vendosjen e posterve siç konstatohet nga Vendimi Nr. 07/353/01-14167 të datës 02.06.2017, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit të Gjakovës, të cilët poster janë të dimensioneve të panove promovuese.

Mbi këtë bazë paneli konsideron se koalicioni në fjalë nuk ka kryer shkelje të nenit 33 pika (b) të LZP-së dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr.182/2017 më datën 10.06.2017.



Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.